



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

*Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën*



**PROCES VERBAL**

**PËR VOTIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT HETIMOR “PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË SË VEPRIMEVE TË KRYERA NGA ANA E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË KUADËR TË USHTRIMIT TË KOMPETENCAVE TË TIJ LIDHUR ME ZHVILLIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE SI DHE PËR TË KONTROLLUAR E LIGJSHMËRINË E VEPRIMEVE DHE PROCEDURËS TË NDJEKUR NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË KUADËR TË EMËRIMIT TË GJYQTARËVE KUSHTETUES” TË PARASHIKUAR NË SEANCËN PLENARE DATË 27 KORRIK 2020, ORA 10:00**

Kuvendi, me Urdhër nr. 40, datë 24.7.2020 të Kryetarit të Kuvendit, u mbledh në seancë plenare për të shqyrtuar raportin përfundimtar të komisionit hetimor “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore si dhe për të kontrolluar e ligjshmërinë e veprimeve dhe procedurës të ndjekur nga Presidenti i Republikës në kuadër të emërimit të gjyqtarëve kushtetues” sipas kalendarit të punimeve të Kuvendit të miratuar me mirëkuptim me vendimin nr. 22, datë 22.07.2020 të Konferencës së Kryetarëve. Seanca plenare filloi punimet me diskutimin e çështjes sipas minutazheve të vendosura paraprakisht në Konferencën e Kryetarëve.

Në mbështetje të nenit 112 të Rregullores dhe ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” raporti përfundimtar kërkon aplikimin e formës së hapur të votimit.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 dhe masave të distancimit të detyrueshëm votimi u organizua me fletë votimi. Konceptimi dhe përgatitja e fletëve u realizua nga Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën si organi përgjegjës që ndjek dhe mbikëqyr veprimtarinë procedurale të Kuvendit në seancë plenare. Në analogji me nenin 60, pika 4 të Rregullores

fleta përmbante objektin e votimit si dhe alternativat e votimit “pro”, “kundër” dhe “abstenim”.

Fletët e votimit u shpërndanë gjatë zhvillimit të seancës plenare. Fleta e votimit përmbante alternativat pro, kundër dhe abstenim. Deputetët shprehën vullnetin me shenjë të dallueshme dhe të qartë në kutitë përkatëse të fletëve të votimit dhe pasi nënshkruan atë e hodhën në kutitë e vendosura në vend të dukshëm në qendër të sallës së seancës plenare.


Shërbimi i Seancës Plenare, nën mbikëqyrjen e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën u kujdes për të zhvilluar procedurën e numërimit të votave. Për të respektuar distancimin fizik të Sekretariatit dhe Shërbimit të Seancës Plenare që u angazhua në këtë proces, numërimi i votave u krye jashtë sallës së seancës plenare por brenda godinës (zyra e mbledhjeve).

Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën vijoi me procedurën e numërimit dhe vlerësimit të votave si dhe nxjerrjes së rezultatit. Pas pasqyrimit të të dhënave respektive, mbi bazën e numërimit të votave, Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën i përcjell Kryetarit të Kuvendit rezultatit për këtë çështje.

Në bazë të fletëve të vendosura në kutitë e votimit rezulton se kanë marrë pjesë në votim 103 deputetë. Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën vlerëson se kuorumi është në përputhje me nenin 78 të Kushtetutës dhe nenin 55 të Rregullores së Kuvendit.

Nga numërimi u konstatua se ishin nënshkruar dhe firmosur nga deputetë gjithsej 103 fletë votimi.

Kuvendi që prej shtatorit 2017 në faqen zyrtare në internet, në rubrikën “Si kanë votuar deputetët” pasqyron vullnetin e shprehur nga çdo deputet në procesin e vendimmarrjes. Çdo deputet pasi të njihet me rezultatit e votimit ka të drejtë të kërkojë sqarim apo të ankohet në Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën.

  
**Anëtar**  
Adnor Shameti

**Anëtar**  
Enver Roshi


**Sekretar**  
Alket Hyseni

  
2020



**Anëtar**  
Edmond Leka

**Anëtar**  
Arlind Çaçani

  
2

**Raporti përfundimtar i komisionit hetimor  
“Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e  
Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit  
të kompetencave të tij lidhur me zhvillimin e zgjedhjeve për  
organet e qeverisjes vendore si dhe për të kontrolluar e  
ligjshmërinë e veprimeve dhe procedurës të ndjekur nga  
Presidenti i Republikës në kuadër të emërimit të gjyqtarëve  
kushtetues”**

**REZULTATI I VOTIMIT**

<b>VOTIMI</b>		
<b>PRO</b>	<b>KUNDËR</b>	<b>ABSTENIM</b>
<b>78</b>	<b>17</b>	<b>8</b>

